



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

**VENDIM**  
**Nr. 610, datë 10.12.2020**

**PËR**  
**PËRFUNDIMIN PA VENDIM PËRFUNDIMTAR TË PROCEDURËS SË**  
**PËRSHPEJTUAR TË DETYRUAR TË VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL**  
**VITI KALENDARIK 2019, PËR GJYQTAREN {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronja “a” dhe “ë” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 85 e vijues të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 61 pika 1, 63 dhe 86 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263 datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, nr. 70 datë 07.02.2020 “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve” dhe atë nr. 594, datë 26.11.2020, me propozim të relatores së çështjes znj. Brunilda Kadi;

**VENDOSI:**

1. Përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional, viti kalendarik 2019, për gjyqtaren {...}, për shkak të përfundimit të procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë me vendimin nr. 594, datë 26.11.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Viti kalendarik 2019 do të përfshihet në periudhën 5-vjeçare të vlerësimit etik dhe profesional në të cilën ai bën pjesë, sipas parashikimeve të nenit 84 pika 2 të Ligjit për Statusin.
3. Një kopje e vendimit t’i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**